



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1461/6 prot.

Datë 23.09.2021

V E N D I M
Nr. 667/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-98529-06-18-2021, me objekt: “Shërbim për mirëmbajtjen e varrezave publike”, me fond limit 14,527,520 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kuçovë
Adresa: Lagjja Nr.1, blloku “Tafil Skëndo”, Kuçovë

Ankimues: Operatori ekonomik “Pienvi” SHPK
Adresa: Rr. “Bardhok Biba” & “Barikadave”, ish Kinema “17 Nëntori”, Tiranë.

Subjekte të interesuara: Operatori ekonomik “Sark” SHPK
Adresa: Lagjja “8 Shkurti”, Rr. “Skënderbej”, Fier.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit

të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.06.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-98529-06-18-2021, me objekt: “Shërbim për mirëmbajtjen e varrezave publike”, me fond limit 14,527,520 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

II.2. Në datën 19.07.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë:

- | | |
|---------------------|---------------------------------------|
| 1. “Sark” SHPK | 12,410,237 lekë pa tvsh, kualifikuar; |
| 2. “Pienvi” SHPK | 13,983,628 lekë pa tvsh, kualifikuar; |
| 3. “Elda - V1” SHPK | pa ofertë ekonomike, skualifikuar; |

II.3. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në buletin nr.119, datë 09.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Sark” SHPK.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 09.08.2021 operatori ekonomik ankimues “Pienvi” SHPK ka paraqitur ankesë pranë

Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se në datën 10.08.2021 operatori ekonomik ankimues “Pienvi” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1461/2 prot., datë 10.08.2021, janë publikuar kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Sark” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 2711 prot, datë 13.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1461/3 prot datë 16.08.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Pienvi” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

II.8. Operatori ekonomik “Sark” SHPK nuk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Pienvi” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pienvi” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit.

III.1.1. Në nenin 4, pika 41, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se: *“Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”*

III.1.2. Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”

III.1.3. Në datën 17.09.2021, me anë të shkresës nr. 1461/4 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “Pienvis” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekrani” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijëni nga ankimuesi mbi njoftimin e fituesit.

III.1.4. Në datën 21.09.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1461/5 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues “Pienvis” SHPK, me anë të së cilës ka bashkëlidhur “Printim ekrani” të rubrikës mesazhe në llogarinë e tij në SPE, me anë të së cilës vërteton se nuk është njoftuar nëpërmjet SPE lidhur me njoftimin e fituesit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*. Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.119, datë 09.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: *“Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”*”.

III.1.6. Sa më sipër, bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon se në rastin konkretë, përllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e marrjes dijëni nga operatorët ekonomik mbi njoftimin e fituesit dhe përfundon ditën e shtatë. Komisioni thekson se për sa kohë që, operatori ekonomik “Pienvis” SHPK, nuk ka marrë dijëni nëpërmjet SPE mbi njoftimin e fituesit, si dhe për sa kohë që në formularin standard të njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.119, datë 09.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është përcaktuar se me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, atëherë përllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë sipas nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nis që nga data 09.08.2021, dhe

përfundon në ditën e shtatë. Sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Pienvis” SHPK është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar, e për rrjedhojë Komisioni vendosi të shqyrtojë në themel këtë ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pienvis” SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK, për mospërmbushje të kriterit lidhur me përvojën e mëparshme, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit ushtrimorë duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Këto shërbime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur shërbimi është realizuar me institucione shtetërore, operatorët ekonomik ofertues do ta vërtetojnë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, operatorët ekonomik ofertues do ta vërtetojnë këtë shërbim vetëm me fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë : Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar ne fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë : Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor ; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.”

III.2.2. Në shtojcën “Preventivi përmbledhës”, e ngarkuar në SPE nga autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

“

Nr	An	Emertimi punimeve	Njesia	Sasia/vjetor
1	An	Pastrim rruge e sheshe të betonit në varreza.	m2	949,440
2	3.1	Prerje bari,kositje,pastrim dhe m,mbajtje pem.shk.d	m2	126,960
3	An-3	Riparim shtresa betoni,rruge e sheshe.	m2	660
4	An	Riparim bordura monolite 15x35	ml	20
5	An	Riparim muri rrethues me tulla	ml	8
6	An	Riparim muri rrethues me blloqe	ml	8
7	An	Riparim muri rrethues me gurë	ml	5
8	An	Riparim muri rrethues me rrjet gabion pa themelin	ml	60
9	An	Riparim muri rrethues me rrjet gabion me themel	ml	6
10	2.121	Rip.brez(korniza)betoni mbi mur tulle,blloqe, guri.	m3	2
11	2.401	Lyerje me bojë vaji të konstruksioneve metalike	m2	4
12	2.399	Shërbetisje e bojatisje me gëlqere	m2	120
13	An	Riparim konstruksione metalike,portave hyrje dalje	m2	5

14	An	Riparim qivuri, nga lëvizja e tokës			Cope	5
15	An	Zvendësim pllake mermeri e dëmtuar në qivure			m2	8
16	An	Zvendësim pllake graniti e dëmtuar në qivure			m2	8
17	An	Zvendësim pllake granili e dëmtuar në qivure			m2	2
18	An	N/Shtres Zhavorri 10 Cm			m2	90

III.2.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Sark” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë nr. 4541 prot., datë 09.11.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Rikonstruksion i godinës 1-katëshe pranë spitalit Roskovec”, me vlerë 757,450 lekë pa TVSH, shoqëruar me situacion përfundimtar dhe akt-kolaudimi;
2. Kontratë nr. 2791 prot., datë 18.09.20219, lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Shpenzime për lyerje meremetime, dezinfektim ambientesh Bashkia Prrenjas”, me vlerë 7,391,707 lekë me TVSH, shoqëruar me situacion pjesor, situacion përfundimtar, akt-kolaudimi dhe akt-marrje në dorëzim;
3. Kontratë nr. 1851 prot., datë 08.06.2020, lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Blerje materialesh për rikonstruksion trotuaresh, lulishte, tenda për tek varrezat e qytetit Prrenjas dhe meremetime të godinave të bashkisë”, me vlerë 3,736,724 lekë pa TVSH, shoqëruar me situacion përfundimtar dhe vërtetim realizimi;
4. Kontratë nr. 2073/16 prot., datë 30.09.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Ura Vajgurore dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Ndërtim KUZ lagjja “18 Tetori” Dafinat Ura Vajgurore”, me vlerë 1,043,465 lekë pa TVSH, shoqëruar me, certifikatën e marrjes në dorëzim paraprak të punimeve, situacion përfundimtar, akt kolaudimi, certifikatë garancie dhe faturë tatimore shitje;
5. Kontratë nr. 7946 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Rikualifikimi i dy qendrave urbane të qytetit”, me vlerë 1,293,825.42 lekë pa TVSH, shoqëruar me situacion pjesor, situacion përfundimtar, akt-kolaudimi, akt-marrje në dorëzim e përkohshme dhe fatura tatimore shitje;
6. Kontratë nr. 7935 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës së Rrahit, pranë objektit të kultit, Arramerras Fushë-Krujë”, me vlerë 1,535,565 lekë pa TVSH, shoqëruar me situacion përfundimtar, akt-kolaudimi, akt-marrje në dorëzim e përkohshme dhe faturë tatimore shitje;
7. Kontratë nr. 93 prot., datë 30.04.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Gjirokastrë dhe operatorit ekonomik “Sark” SHPK me objekt: “Shpenzime mirëmbajtje rruge”, me vlerë 528,537 lekë, shoqëruar me, situacion pjesor, situacion përfundimtar dhe fatura tatimore shitje;

III.2.4. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.2.5. Në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit, si dhe rregullat e prokurimit publik.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK, në përmbushje të kriterit për shërbime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “Sark” SHPK, me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se ky i fundit, dëshmon se ka kryer punime të ngjashme vetëm për një pjesë të shërbimeve/punimeve, pasi dëshmitë e

paraqitura nga operatori ekonomik “Sark” SHPK lidhen vetëm me punime ndërtimore ose mirëmbajtje gjithashtu me natyrë ndërtimore, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për shërbimin e pastrimit apo të mirëmbajtjes së lulishteve, të cilat, referuar volumeve sasiore të parashikuara në preventiv, si edhe vlerës së ofruar për këto dy zëra, në preventivin e paraqitur nga vetë operatori ekonomik “Sark” SHPK, zënë mbi 80 % të volumit të kontratës që prokurohet. Komisioni vlerëson se shërbimi i pastrimit dhe të mirëmbajtjes së lulishteve kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimuesi me anë të kontratave të sipërcituara. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë mirëmbajtje, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve/shërbimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka pasur punime/shërbime të ngjashme me pjesën më të rëndësishme të shërbimeve objekt-prokurimi. Gjithashtu, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimet objekt-prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Sark” SHPK nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me përvojën e mëparshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Pienvi” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Pienvi” SHPK për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pienvi” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-98529-06-18-2021, me objekt: “*Shërbim për mirëmbajtjen e varrezave publike*”, me fond limit 14,527,520 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Sark” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sark” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri